



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E KULTURËS

**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

**VENDIM**

**Nr. 216, dt.13.10.2015**

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim të KKR nr. 75, dt.03.04.2015, “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” në mbledhjen e datës 13.10.2015, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për shoqërinë e ndërtimit “ **B.M. Konstruksion**” sh.p.k, me drejtues teknik restaurator *ing. Adrian Kalamishi*, me licensë personale profesionale në zbatim, R.P. 56,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “ *B.M. Konstruksion*” sh.p.k, me drejtues ligjor z. *Mark Gjeka* për pajisje me licencë në fushën e restaurimit për kategorinë:  
**CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”.**
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licencë restaurimi për shoqërinë “ *B.M. Konstruksion*” sh.p.k, për kategorinë:  
**CZ: “Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik restaurator *ing. Adrian Kalamishi*.**
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO PURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**